



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Doretuar Primitjen / Prodato Received / Delivery	02.09	2	vll god yegr
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICKA	5122/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.672/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.672/2022 të datës 27.07.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 02.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ lidhur me ankesën A.nr.672/2022 të datës 27.07.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën “Udhëheqës i Divizionit për të Huajt në kuadër të Departamentit për Shtetësi në Ministrinë e Punëve të Brendshme” sipas Akt emërimit me nr.332 i datës 07.05.2018, me datën 27.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4357/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me nr.ref.1153 i datës 21.07.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vazhdim të afatit edhe për 30 ditë kalendarike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 01.08.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë te ankuesit tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa me datë 12.08.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër A.nr.672/2022 me numër të protokollit 4357/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 27.07.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi nr.1153 i datës 21.07.2022 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimi A.nr.409/2022 i datës 03.06.2022 me numër protokollit 3252 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 23.06.2022 me numër protokollit 990 për shfuqizimin e vendimit me numër protokollit 565/2022 për transferim i Menaxheres së Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPB; E-mail zyrtar i datës 24.06.2022; E-mail zyrtar i datës 24.06.2022 -njoftim për inicimin e procedurës disiplinore; E-mail zyrtar i datës 24.06.2022-njoftim për pezullim nga detyra; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 12.08.2022 me numër protokollit 4683/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Ndryshimi i Aktit të emërimit me nr.332 i datës 07.08.2022; Vendimi me nr. protokollit 1225 i datës 24.06.2022; Vendimi i datës 21.07.2022 me numër protokollit 1153 /2022 për shtyrje të afatit në procedurë administrative; Vendimi i datës 07.04.2022 me nr.565 për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil; Deklaratë nga nëpunësit e Divizionit për të huaj; E-mail zyrtar i datës 29.03.2022; E-mail zyrtar i datës 01.04.2022; E-mail zyrtar i datës 01.04.2022-njoftim; Njoftimi i datës 01.04.2022; Njoftimi i datës 01.04.2022; Njoftim i datës 15.10.2021 për gjendjen aktuale të Divizionit për të huaj; E-mail zyrtar i datës 29.03.2022 -kërkesë; E-mail zyrtar i datës 15.10.2021 dhe e-mail zyrtar i datës 23.06.2022-Kërkes për veprim urgjent dhe Vendimi i Komisionit Disiplinor me numër 1334 i datës 22.08.2022 i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit, është **bërë i pamundur, sepse:**

Duke shqyrtuar ankesën e ankuesit dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në lidhje me objektin e kësaj ankese me datën 25.08.2022 nga organi i punësimit ka pranuar vendimin e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme me Nr.1334 të datës 22/08/2022 përmes së cilit është vendosë për çështjen kryesore sipas objektit të inicimit të procedurës disiplinore dhe poashtu përmes këtij vendimi është shfuqizuar vendimi me Nr.1025/2022 i datës 24.06.2022 për pezullimin e _____ nga pozita e Udhëheqësit të Divizionit për të Huaj në kuadër të Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migracion.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në pretendimin ankimor të ankuesit i cili përmes kësaj ankese kërkon që të anulohet vendimin me nr.1153 të datës 21.07.2022 të Komisionit Disiplinor për shtyrje të afatit për vendimmarrje në procedurë administrative edhe për 30 ditë kalendarike, duke pasur parasysh faktin se ky vendim është nxjerrë më datë 21/07/2022 ndërsa tashmë me nxjerrjen e vendimit me Nr.1334 të datës 22/08/2022, i njëjti nuk ka asnjë efekt juridik dhe mbi këtë bazë ligjore duke i'u referuar dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: „ *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*”, konstaton se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e datës 27.07.2022 të ankuesit është bërë i pamundur sepse me datën 22.08.2022 Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka nxjerr vendimin Nr.1334 i cili ka vendosë për çështjen kryesore që ka qenë objekt i procedurës



disiplinore me të cilin ka shfuqizuar edhe vendimin me Nr.1025/2022 të datës 24.06.2022 për pezullimin e nga pozita e Udhëheqësit të Divizionit për të huaj në kuadër të Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migracion dhe se ndaj të njëjtit vendim deri më tani nuk kemi pasur ankesë të veçantë dhe se tashmë objekti i ankesës sa i përket shtyrjes së afatit të vendimmarrjes nga komisioni disiplinor sipas vendimit me nr.1153 të datës 21.07.2022, është bërë i pamundur bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të specifikuar si më lartë.

Andaj, bazuar në këto rrethana, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.672/2022, datë 02.09.2022.

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

